OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA – OST SHA
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR ME 31 DHJETOR 2015

(shumat jane te shprehura ne leke)	*Shenime*	***OST sh.a. 31 Dhjetor 2015***	***OST sh.a. 31 Dhjetor 2014 (e riparaqitur)***	***OST sh.a. 01 Janar 2014 (e riparaqitur)***
AKTIVET				
Aktivet afatgjata				
Aktive afatgjata materiale	7	50,943,268,694	42,252,127,188	39,400,372,375
Aktive afatgjata jomateriale		85,636,539	49,489,033	52,610,041
Aktive financiare afatgjata	10	15,201,308	18,699,838	117,844,960
		51,044,106,541	**42,320,316,059**	**39,570,827,376**
Aktivet Afatshkurtra				
Inventari	9	711,041,469	905,163,071	907,373,800
Llogari të arkëtueshme e të tjera	8	9,549,573,086	9,722,495,962	6,818,594,558
Aktive financiare afatshkurter	10	5,132,332	103,814,497	151,846,755
Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra	12	190,661,087	1,437,187,386	2,073,547,066
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	11	612,673,151	1,257,653,438	467,866,139
Tatim aktual i paguar teper	24	43,467,617		22,529,585
		11,112,548,742	**13,426,314,354**	**10,441,757,902**
Totali I aktiveve		**62,156,655,283**	**55,746,630,413**	**50,012,585,278**
Kapitali neto dhe detyrimet				
Kapitali				
Kapitali aksionar		9,694,008,000	9,694,008,000	9,694,008,000
Rezerva ligjore		537,509,002	443,027,070	364,791,062
Rezerva nga rivlerësimi per huate	15	1,643,648,478	1,528,413,038	1,441,063,232
Rezerva rivlersimi		9,007,713,978	8,860,568,681	9,533,897,177
Rezerva te tjera		2,936,205,223	1,330,012,375	471
Fitime e pashperndara		3,524,031,099	1,310,775,456	661,176,523
Fitime/humbje te vitit financiar		1,236,142,636	1,781,714,867	1,565,695,410
Totali I kapitalit neto		**28,579,258,416**	**24,948,519,486**	**23,260,631,875**
Detyrimet afatgjata				
Huate afatgjata	14	22,579,081,808	20,715,918,476	13,087,525,806
Llogari te pagueshme tregtare e te tjera	13	971,116,948	491,620,309	404,502,255
Grantet	17	620,113,880	591,281,331	659,906,172
Tatime te shtyra per PPE	18	1,439,993,317	1,453,877,399	1,550,348,099
Totali I pasiveve afatgjata		**25,610,305,952**	**23,252,697,515**	**15,702,282,332**
Detyrimet afatshkurtra				
Llogari te pagueshme tregetare dhe llog	13	3,377,538,767	4,133,515,349	2,548,272,999
Parapagimet dhe te ardhurat e shtyra	16	259,738,665		
Hua dhe parapagimet	14	4,329,813,482	3,371,679,461	8,501,398,073
Tatim aktual i paguar teper	24		40,218,601.95	
Totali I pasiveve		**7,967,090,915**	**7,545,413,411**	**11,049,671,072**
Totali I kapitalit neto dhe pasiveve		**62,156,655,283**	**55,746,630,413**	**50,012,585,278**

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 40 që janë pjesë përbërëse e Pasqyrave Financiare të OST sh.a.

Pasqyrat financiare u aprovuan më 20 Qershor 2016 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori	Drejtori i Drejtorisë Ekonomike	Shefe e Sektorit te Administrimit dhe Kontabilitetit
Engjell ZEQO	Ervin ALLIU	Arjola QIRKO

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA – OST SHA
PASQYRA KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015

(shumat jane te shprehura ne leke)	*Shenime*	***OST sh.a.*** ***31 Dhjetor 2015***	***OST sh.a.*** ***31 Dhjetor 2014***
Te ardhurat	19	6,092,989,527	6,873,797,590
Te ardhura te tjera	19	255,936,503	13,496,691
Mallra, lende te para e sherbime	20	(615,005,146)	(468,655,045)
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	21	(379,109,239)	(1,203,363,239)
Shpenzime te Personelit	22	(1,020,193,973)	(993,114,603)
Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi	7	(1,629,916,466)	(1,613,960,437)
Humbje nga renia ne vlere e aseteve	7	(1,456,785,573)	-
Humbje nga renia ne vlere I te drejtave dhe detyrimeve		(12,873,839)	-
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		**1,235,041,793**	**2,608,200,957**
Te ardhurat e shpenzimet financiare	23	(32,986,631)	(381,149,035)
Totali i te ardhurave e shpenzimeve financiare		**(32,986,631)**	**(381,149,035)**
Fitimi (humbja) para tatimit		**1,202,055,162**	**2,227,051,922**
Shpenzimet e tatimit te fitimit	24	(463,090,672)	(541,807,756)
Shpenzimet e tatimit te shtyre	18	497,178,145	96,470,700
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		**1,236,142,636**	**1,781,714,866**
Te ardhurat gjithe perfshirese:			
Shtesë/(pakësim) në rezervë nga rivlerësimi i aseteve		3,221,960,418	
Tatimi I shtyre per rezerven e rivleresimit		(483,294,063)	
Totali te ardhurave gjitheperfshirese per vitin		**3,974,808,990**	**1,781,714,866**

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjitheperfshirese duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të OST sh.a.

Administratori	Drejtori i Drejtorisë Ekonomike	Shefe e Sektorit te Administrimit dhe Kontabilitetit
Engjell ZEQO	Ervin ALLIU	Arjola QIRKO

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA – OST SHA
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015

(shumat jane te shprehura ne leke)

	Aksionerët e Shoqërisë					
	Kapitali Nenshkruar	**Rezerva nga rivleresimi**	**Rezerva Ligjore**	**Rezerva te tjera**	**Fitimi i pasherndare**	**Totali**
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	**9,694,008,000**	**10,831,146,266**	**364,791,062**	**471**	**1,564,011,047**	**22,453,956,846**
Efektet e riparaqitjes per huate		1,441,063,232			(634,388,203)	806,675,029
Kontabilizimi per rimarjen e rezerves se rivleresimit 2012-2013		(1,297,249,090)			1,297,249,090	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013 (e riparaqitur)	**9,694,008,000**	**10,974,960,408**	**364,791,062**	**471**	**2,226,871,934**	**23,260,631,875**
Saktesime				(232)	(862)	**(1,094)**
Zmadhim kapitali						-
Kontabilizimi per rimarjen e rezerves se rivleresimit 2014		(648,624,545)			648,624,545	-
Kontabilizimi I rezerves se rivleresimit te huave		87,349,806				**87,349,806**
Fitimi neto per periudhen ushtrimore					1,781,714,867	**1,781,714,867**
Divident i paguar					(156,472,016)	**(156,472,016)**
Rritje e rezerves se Kapitalit		(24,703,950)				**(24,703,950)**
Fitim I pa shperndare			78,236,008	1,330,012,136	(1,408,248,144)	-
Tatim I shtyre per rezerven e rivlersimit						-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	**9,694,008,000**	**10,388,981,718**	**443,027,070**	**1,330,012,375**	**3,092,490,325**	**24,948,519,488**
Fitimi neto per periudhen ushtrimore					1,236,142,636	**1,236,142,636**
Fitim/humbje e pashperndare					(222,795,448)	**(222,795,448)**
Sistemimi I rezerves se 2004		(1,737,441,722)			1,737,441,722	-
Sistemimi i diferencave te rezerves		(41,831,903)			41,831,903	-
Zmadhim kapitali						-
Divident i paguar					(188,963,864)	**(188,963,864)**
Rritje e rezerves se Kapitalit						-
Shperndarja e fitimit ne baze te shkreses 5182/1 date 01.07.2015			94,481,932	1,606,192,848	(1,700,674,780)	-
Kontabilizimi I rezerves se rivleresimit te huave		115,235,440				**115,235,440**
Axhustim I rezerves se rivleresimit per interesin e kapitalizuar		(47,546,190.00)				**(47,546,190)**
Realizimi I rezerves se rivleresimit		(709,130,083)			709,130,083	-
Sistemim I rezerves se rivleresimit per asetet e nxjerra jashte perdorimit		(55,571,158)			55,571,158	-
Ulje e rezerves nga rivleresimi I aseteve		(986,102,130)				**(986,102,130)**
Rritje e rezerves nga rivleresimi I aseteve		4,208,062,548				**4,208,062,548**
Tatimi I shtyre per rezerven e rivleresimit		(483,294,063)				**(483,294,063)**
Gjendja me 31 Dhjetor 2015	**9,694,008,000**	**10,651,362,457**	**537,509,002**	**2,936,205,223**	**4,760,173,735**	**28,579,258,417**

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Administratori
Engjell ZEQO

Drejtori i Drejtorisë Ekonomike
Ervin ALLIU

Shefe e Sektorit te Administrimit dhe Kontabilitetit
Arjola QIRKO

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST sh.a) u krijua si shoqëri anonime në korrik 2004 bazuar në Vendimin nr. 797 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2003.

Shoqëria u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare SHA ("KESH"). Kapitali i nenshkruar ishte 2 milione Lekë. Bazuar në urdhrin nr. 63 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë, datë 18 mars 2004, kapitali i KESH-it duhet të reduktohej me vlerën e aktiveve të Shoqërisë dhe Shoqëria do të vepronte më vete si një shoqëri e zotëruar nga shteti.

Në vitin 2006 Shoqëria mori liçencën për transmetim energjie nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri dhe në vijim nënshkroi një marrëveshje për shërbime transmetimi me KESH.

Bazuar në urdhrin nr. 329 të Ministrisë se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, datë 9 maj 2008, pronësia e OST sh.a iu transferua kesaj Ministrie, ndryshime te cilat u bene efektive nga data 01 Janar 2008.

Mbështetur në vendimin Nr. 20, datë 10 nëntor 2010 të Këshillit Mbikëqyrës, u themelua OST Security SHA, me kapital te nenshkruar prej 4 milione lekë, të zotëruar 100% nga OST sha. OST Security u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 1 dhjetor 2010. Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është ruajtja e objekteve në pronësi dhe administrim të OST.

Në bazë të vendimit Nr 31 date 05/10/2015 te Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a dhe vendimit Nr. 16 date 20/10/2015 te Asamblese se Pergjithshme te OST Security sh.a u vendos të fillohet me procedurat e likuidimit të OST Security. Shoqëria e kontrolluar nuk është materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara të OST sh.a.

Shoqëria e ka seline qendrore në Shqipëri. Adresa kryesore është Autostrada Tirane – Durres, Km 9 Yrshek Kashar, Tirane, Shqiperi.

Aktualisht OST sha e ushtron aktivitetin e saj nepermjet 6 Njesive Operative dhe Drejtorise se Pergjithshme.

Administratori i shoqerise eshte Z. Engjell ZEQO.

Shoqeria eshte subjekt i tatimpaguesve te medhenj rregjistruar me NIPT K42101801N.

Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA ("Shoqëria") ka si objekt te vetem te veprimtarise se saj ate të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri.

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare te OST Sha dhe Pasqyrat Financiare te OST Security (si shoqeri e lidhur me kapital 100%).

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare te kohsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të mëposhtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në proçesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë.Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose

fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet shpjeguese pjese perberese te pasqyrave financiare.
Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015.Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit finaciar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2015.

Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Lek.

Krahasueshmeria
Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar.
Ne 01.01.2015 Shoqeria ka kryer rivleresimin e aseteve sipas celjes me 01.01.2015.
Gjithashtu OST sh.a ka kontraktuar bashkimin e operatoreve ekonomik "Deloitte Audit Albania" shpk dhe "Deloitte Albania" shpk per Vlerësimin i huave me vlerë të drejtë në momentin fillestar dhe mbajtjen e tyre me kosto të amortizuar.

Keto dy rivleresime kane nxjerre te nevojshme riparaqitjen e zerave te llogarive per periudhat krahasuese si me 01 Janar 2014 dhe 31 Dhjetor 2014 per te paraqitur ne menyre retrospektive ndryshimin ne politiken kontabel per transferimin e shumes se rezerves se rivleresimit si dhe efektin e vleresimit me vleren e drejte te huave afatgjata ne momentin fillestar dhe mbjajtjen e tyre me kosto te amortizuar. (referojuni shenimit shpjegues 4.1)
Shumat përkatëse krahasuese më 31 Dhjetor 2014 janë riklasifikuar në përputhje me paraqitjen e vitit aktual.

(a) Ndryshimet në politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ndryshimet e kërkesave për dhënie informacioni.

Standartet e reja, amendimet e standarteve dhe interpretimeve të paraqitura më poshtë, janë të detyrueshme për zbatim në pasqyrat financiare për vitin që fillon më 1 Janar 2015, por që nuk pritet të sjellin ndryshime të rëndësishme në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Amendimet e SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve"
(emetuar ne Nentor 2013 dhe efektiv per periudhat qe fillojme me 1 Korrik 2014)

Këto amendime eleminojnë përqasjen corridor dhe llogarisin kostot financiare mbi një bazë të financimit neto. Shoqeria duhet të vlerësojë impaktin që do të kenë këto ndryshime në pasqyrat financiare.

Amendimet e SNK 32 "Kompesimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare"
(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014)

Këto ndryshime janë për udhëzimin e aplikimit të SNRF 32 " Instrumentat financiarë paraqitja" duke sqaruar disa nga kërkesat për kompesimin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare në bilancin kontabël.

Amendimi ne SNRF 36, "Dhenia e informacionit mbi shumat e rikuperueshme per aktivet jo-financiare"

(Emetuar ne Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014)

Aplikimi i meparshem eshte i lejuar nqs eshte aplikuar SNRF 13 per periudhen kontabel dhe periudhen krahasuese. Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

Amendimi ne SNRF 39, "Zevendesimi I Derivateve dhe vijimesia e Kontabilitetit Mbrojtes" *(Emetuar ne Qershor 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014).*

Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.Ne daten e aprovimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet e meposhtme, interpretimet dhe rishikimet jane emetuar por nuk jane ende efektive:

Standartet e reja, amendimet e standarteve dhe interpretimeve të paraqitura më poshtë, janë të publikuara por akoma jo efektive deri ne daten e leshimit te pasqyrave financiare te Shoqerise. Shoqeria synon ti adoptoje këto standarte kur ato të bëhen efektive.

SNRF 9 Instrumentat Financiare
(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2015)

SNRF 9 është standarti i parë i lëshuar si pjesë e një projekti më të gjerë për të zëvendësuar SNK 39. SNRF 9 ruan por thjeshton modelin e përzier të matjes dhe krijon dy kategori kryesore të matjes për aktivet financiare: koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë. Baza e klasifikimit varet nga modeli i aktivitetit të tij si dhe karakteristikat kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare të aktivit financiar. Udhëzimi në SNK 39 për zhvlerësimin e aktiveve financiare dhe kontabilitetin mbrojtës vazhdon të zbatohet.

SNK 27 "Pasqyrat Financiare Individuale
(Emetuar me 12 Gusht 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me 1 Janar 2016)
SNK 27 (rishikuar në 2011) përfshin kërkesa në lidhje me pasqyrat financiare individuale.

SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta.
(Emetuar me 11 Shtator 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016)

SNK 28 (rishikuar ne 2011) përfshin kërkesat për investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta që duhet të llogariten njësoj duke ndjekur çështjet e SNRF 11. *Shitje ose Kontribut ne asete midis nje Investitori dhe bashkepunetorit te tij ose sipermarrjes se perbashket*

Amendime ne SNRF 11, Kontabilizimi per blerjet e interesave ne Operacionet e Perbashketa

(Emetuar me 6 Maj 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).

Amendimi ne SNRF 14, Llogarite rregullatore e shtyrjes

(Emetuar ne Janar 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).

Amendime ne SNK 16 dhe SNK 38, Qartesimi i metodave te pranueshme per Amortizimin dhe Zhvleresimin

(Emetuar me 12 Maj 2014 dhe edektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2016).

Amendime ne SNRF 15, Te ardhurat nga Kontratat me Klientet

(Emetuar me 28 Maj 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 janar 2017).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve afatgjata materiale dhe huave afatgjata, të rivlerësuara me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në Lekë (LEK), e cila është monedha funksionale e Shoqerise.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i Shoqerise të ushtrojë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacionet mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara përshkruhen në shëniminet 3, 5.1 dhe 6.

3. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Shoqeria bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Rezultatet e vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material në vlerën e mbetur te aktiveve dhe detyrimeve në vitin pasardhës janë diskutuar si më poshtë.

4. Politika të rëndësishme kontabël

Me përjashtim të ndryshimeve të mëposhtme, Shoqeria ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

(a) Baza e konsolidimit

Filialet

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Shoqeria. Kontrolli ekziston atëherë kur Shoqeria ka fuqinë të drejtojë politikat financiare dhe operacionale të një njësie, me qëllim që të përfitojë nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit, merren në konsideratë të drejtat potenciale votuese që janë aktualisht në fuqi. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e mbarimit të tij. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar ne politika kontabël uniforme për transaksione të ngjashme dhe çështje të tjera në kushte të njëjta.

Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit

Tepricat brenda Shoqerise, dhe ndonjë shumë e parealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda Shoqerise (përvec fitimeve ose humbjeve nga këmbimet në monedha të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e parealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

(b) Transaksionet ne monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos të amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë.

Kurset kryesore të këmbimit ndaj Lekut janë:

	31 Dhjetor 2015	***31 Dhjetor 2014***
1 EUR	137.28 Lek	140.14 Lek
1 USD	125.79 Lek	115.23 Lek
1 CHF	126.74 Lek	116.52 Lek
100 YEN	104.50 Lek	96.49 Lek

(c) Inventari

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e kostos mesatare të ponderuar dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit apo të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur kostot e vlerësuara të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

(d) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqeria janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluara të rënies në vlerë. Shpenzimet vijuese të aktiveve afatgjata të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve afatgjata jo-materiale. Jetëgjatësia e parashikuar është 5 vite.

(e) **Aktivet afatgjata materiale**

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale në pasqyren e konsoliduar të pozicionit financiar janë paraqiturme vlerën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit së cilës i zbritet zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje pasardhëse e akumuluar nga rënia e vlerës.

Rivlerësimet janë kryer me intervale të mjaftueshme, të tillë që vlerat kontabël nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato që do të përcaktoheshin duke përdorur vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe raportimi.

Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja kreditohet drejtpërdrejt tek kapitalet e veta nen emertimin plusvlerë (tepricë) rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit e të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje.

Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose ne humbje. Megjithatë, ulja debitohet drejtpërdrejtë tek kapitalet e veta nen emretimin plusvlere (tepricë) rivlerësimi për aq sa ajo mbulon çdo tepricë kreditore tek plusvlere (teprica) rivlerësimi në lidhje me atë aktiv. Rënia që njihet në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse, zvogëlon shumën e akumuluar në kapital në zërin, tepricë nga rivlerësimi.

Teprica e rivlerësimit e përfshirë në kapitalin neto në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të transferrohet drejtpërdrejt tek fitimi i pashpërndarë në se aktivi nuk njihet (çregjistrohet). Kjo mund të përfshijë transferimin e gjithë tepricës nëse aktivi tërhiqet ose nxirret nga përdorimi. Megjithatë, një pjesë e mbivlerës mund të transferohet kur aktivi përdoret nga njësia ekonomike; Në një rast të tillë madhësia e tepricës së transferuar do të jetë diferenca mes amortizimit të bazuar në vlerën kontabël (neto) të rivlerësuar të aktivit dhe amortizimin e bazuar në koston fillestare të aktivit. Transferimi nga teprica (mbivlera) e rivlerësimi tek fitimi i pashpërndarë nuk bëhet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

OST sh.a më parë e ka transferuar rezervën e rivlerësimit te aktiveve afatgjata materiale drejperdrejt ne fitime te pashperndara ne momentin kur aseti perkates eshte terhequr ose ka dale jashte perdorimit. Gjatë vitit 2015 shoqeria e ndryshoi politikën e saj kontabël duke e transferuar nje pjese te rezervës se rivlerësimit në fitimet e pashpërndara gjate kohes qe aseti eshte ne perdorim.

Shoqeria e ka aplikuar këtë ndryshim në politikën kontabël në mënyrë retrospektive duke riparaqitur periudhën krahasuese si më 1 janar 2014.

Nëse pjesë të konsiderueshme të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë ato njihen si aktiv i ndarë më vete (komponentë kryesorë) të aktivit.

Aktivet në proces mbahen me kosto, pakësuar me humbjet e njohura nga zhvlerësimi (nese ka) dhe klasifikohen në kategoritë e duhura të aktiveve afatgjata materiale kur ato përfundohen dhe janë të gatshme për përdorim. Kosto përfshin të gjithë shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me përftimin e aktivit. Këto shpenzime përfshijnë tarifat profesionale, ndërsa për aktivet e kualifikuara kostot e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikat kontabël të Shoqerise.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar çmimin e shitjes me vlerën kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot vijuese

Kosto vijuese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohet nëse pritet që Shoqeria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga këto shpenzime.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet për të anulluar shumat e rivlerësuara të aktiveve afatgjata materiale duke i zbritur vlerën e mbetur sipas metodës lineare të amortizimit, përgjatë jetës së dobishme dhe njihet në fitim ose humbje.

Jetët e dobishme te aktiveve afatgjata materiale për periudhen aktuale dhe atë krahasuese janë si më poshtë:

• Përmirësimet e tokës dhe ndërtesat	16 - 70 vite
• Instalime teknike, pajisje dhe makineri	4 - 55 vite
• Mjete transporti	5 - 20 vite
• Pajisje zyre dhe informatike	5 - 15 vite

Toka, ndërtimet në proces dhe parapagimet ndaj furnitoreve nuk amortizohen.

Shoqëria OST sh.a. ka zgjedhur modelin e rivleresimit te te aktiveve aftagjata, ne zbatim te Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit Nr 16 (SNK) pas njohjes fillestare.

Per sa me larte, në zbatim të urdhërit nr.530 datë 03.12.2014 të ministrit të MZHETTS per rivleresimin e Aktiveve Afatgjatë Materiale, OST sha ka nenshkruar me grupin e eksperteve te emeruar me urdhrin e mesiperm, kontratën me nr.1235 prot, datë 26.02.2015. Ne kete kontrate percaktohet metodologjia, afatet dhe standardet profesionale te zbatueshme. Ne zbatim te kesaj kontrate grupi i ekspertëve vleresues dhe kontabel, pas nje analize te detajuar ka realizuar rivleresimin e aktiveve afatgjata te shoqerise OST sha, dhe ka hartuar raportin perfundimtar.

Rivlerësimi i aktiveve te shoqërisë "OST" sh.a. është bërë duke u bazuar ne keto metoda:

- Kosto e Zëvendësimit e Amortizuar, per ndertesen, linjat e transmetimit dhe makinerite dhe pajisjet
- Metoda e krahasimit te drejtperdrejte per token, mjetet e transportit, pajisjet e zyres dhe inventarin ekonomik

Testi i zhvleresimit

Bazuar në natyrën specifike të aktivitetit të shoqërisë, vlera e drejtë e pjesës më të madhe të AAM është përcaktuar sipas metodës së kostos së zëvendësimit të amortizuar (DRCN). Për këtë qëllim, grupi që ka kryer vlerësimin ka bërë testin e zhvlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale.
Qëllimi i testit të zhvlerësimit është të sigurojë që Aktivet në pronësi të Shoqërisë, janë regjistruar në bilancet financiare në një shumë që nuk tejkalon vlerën e tyre të rikuperueshme.
Nder metodat e vleresimit te bisnesit grupi i eksperteve ka zgjedhur Metoden e Aktualizimit te Flukseve te Parase (Discount Cash Flow) si me te pershtatshme per situaten dhe kushtet ku shoqeria operon.
Testi i zhvleresimit per aktivet afatgjata materiale eshte bere duke u bazuar ne Flukset Monetare qe krijohen nga keto aktive.

Vlera e rikuperueshme e aktiveve eshte:

- Vlera e drejte minus koston e shitjes
- Vlera ne perdorim

Duke mare ne konsiderate se shoqeria nuk ka konkurente te ngjashem ne treg si shume e rikuperueshme e aktiveve afatgjata eshte mare vlera ne perdorim.

Nga procesi i vlerësimit të shoqërisë "OST" sh.a. për qëllime të vlerësimit të aseteve, për të krahasuar vlerën e tregut të shoqërisë me vlerën e shoqërisë sipas librave kontabël ka rezultuar se Vlera në përdorim është më e madhe se Vlera kontabel Neto në nivel shoqërie e cila verteton se asetet e shoqerise nuk janë mbajtur në kontabilitet në tërësinë e tyre me vlerë më të madhe se sa vlera e tyre e rikuperueshme.

(f) Instrumentat financiarë

Aktivet financiare joderivative

Shoqeria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen. Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Shoqeria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqeria çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqerise mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur Shoqeria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga Shoqeria, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqeria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjerat

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuara në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet monetare gjendje si dhe depozitat në të parë me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Llogaritë debitore bankare që përbëjnë një pjesë të menaxhimit të mjeteve monetare të Shoqerise, përfshihen në mjetet monetare dhe ekuivalente me to në pasqyrën e flukseve monetare.

Detyrimet financiare joderivative

Shoqeria fillimisht i njeh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur Shoqeria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Shoqeria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anullohen apo përfundojnë.

Aktivet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqeria ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare joderivative të Shoqerise janë si vijon: hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(g) Huate dhe kostot e huamarrjes

Pas njohjes fillestare huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në interesin efektiv të çdo diference midis kostos dhe vlerës së riblerjes përgjatë periudhës së huamarrjes.

Per sa me larte, OST sh.a ka kontraktuar bashkimin e operatoreve ekonomik "Deloitte Audit Albania" shpk dhe "Deloitte Albania" shpk per Vlerësimin i huave me vlerë të drejtë në momentin fillestar dhe mbajtjen e tyre me kosto të amortizuar.

Ne zbatim te kesaj kontrate ky bashkim operatoresh ekonomik, pas nje analize te detajuar kane realizuar vleresimin e huave, dhe kane hartuar raportin perfundimtar.

Matja Fillestare

Aktivet dhe detyrimet financiare jo me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit ose humbjes financiare, njihen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e aktivit ose detyrimit financiar.

Vlerësimi i vlerës së drejtë

Në funksion të analizës së vlerësimit të llogaritjes së vlerës së drejtë të huave afatgjata, baza e vlerësimit të përdorur është Vlera e Drejtë. Sipas IFRS 13, Vlera e Drejtë është përcaktuar si "çmimi që do merrej në rast shitjeje të një aseti ose që do të paguhej në rast transferimi të një detyrimi, nëpërmjet një transaksioni të rregullt mes pjesmarrësve të tregut në daten e matjes".

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë janë çmimet e kuotuara në një treg aktiv. Megjithatë, në qoftë se tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, vlera përcaktohet nga një teknike vlerësimi, që llogarit çmimin e transaksionit në datën e matjes bazuar në kushtet normale të biznesit, duke përdorur si referencë transaksionet e tregjeve të mbikqyrura, analizën e fluksit monetar të skontuar dhe modelet e vlerësimit të opsioneve. Teknika e vlerësimit përdor maksimumin e të dhënave të tregut duke bërë vlerësime dhe supozime që janë në përputhje me informacionin e disponueshëm dhe që lidhet sa më pak të jetë e mundur në të dhëna specifike te përfshira në metodologjitë ekonomike të pranuara për vlerësimin e instrumentave financiarë.

Tregu i huave sovrane

Portofoli i kredisë së OST përbëhet nga kredi sovrane të cilat janë siguruar nga kreditorë ndërkombëtar nëpërmjet garancive sovrane të Qeverisë Shqiptare ("Garantuesi"). Garantuesi merr përsipër të paguajë në emër të OST në rast se ky i fundit nuk arrin ta paguajë detyrimet.

Si pasojë, për qëllimin e këtij vlerësimi, është konsideruar që përkufizimi i "tregut" për kreditë sovrane të jetë specifik për secilin kreditor.

Normat e interesit të tregut

Në rastin e OST sh.a., duke konsideruar se portofoli i huave është i garantuar nga Ministria e Financave dhe "tregu" përbëhet nga institucione financiare si Banka Botërore, BERZH, KfË, BEI etj.,"normat e interesit të tregut" duhet të reflektojnë politikën e termave dhe kushteve të institucioneve të tilla financiare. Rregulli i përgjithshëm për institucione të tilla është të merret si bazë klasifikimi ekonomik i vendeve, i publikuar çdo vit nga Banka Botërore. Duke filluar nga 2009, Shqipëria klasifikohet si një ekonomi me të ardhura mbi mesatare.

Matjet e mëvonshme të detyrimeve financiare

Pas njohjes fillestare kreditë dhe të arkëtueshmet maten sipas kostos së amortizuar duke përdorur metoden e interesit efektiv.

Kosto e Amortizuar

Kostoja e amortizuar të një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet minus pagesat fillestare, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference mes shumës fillestare dhe shumës në maturim, dhe minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi ose pamundësie arkëtimit. Për kalkulimin e kostos së amortizuar është marrë në konsideratë skeduli i amenduar të pagesave të principalit dhe interesave, vetëm në rastet për të cilat kreditorët dhe Kompania kanë rënë dakord për një amendim.

Metoda e interesit efektiv

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një aktivi apo detyrimi financiar dhe të shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve gjatë periudhës përkatëse.

Norma e interesit efektiv është norma që skonton saktësisht pagesat e ardhshme monetare ose faturat përmes jetës së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë të shkurtër për vlerën bartëse neto të aktivit ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive, të gjitha flukset monetare kontraktuale, të gjitha tarifat e marra dhe të paguara mes palëve, kostot e transaksionit, dhe të gjitha primet ose skontot e tjera janë konsideruar.

Interesi i kapitalizuar

Interesi i kapitalizuar gjatë periudhës 2008-2015 është axhustuar me vlerat e interesint efektiv bazuar në rezultatin e kostos së amortizuar. Për më tepër, diferenca pozitive apo negative midis interesit të kapitalizuar dhe interesit efektiv i është alokuar aktivit respektiv dhe është amortizuar duke përdorur normën e ponderuar të amortizimit për aktivin gjatë periudhës. Diferenca në interes është njohur në Aset për balancën hapëse në 2014 si dhe për vitin 2014. Për aktivet që janë në proçes, diferenca në interesin efektiv është alokuar aktivit në proçes respektiv

Në 1 janar te 2015, OST bëri rivlerësimin e aktiveve, për këtë arsye në çeljen e vitit 2015 diferenca neto midis veprimeve kontabël të çeljes së vitit 2014 dhe vitit 2014 do të regjistrohet në 'Rezervë nga rivlerësimi i aktivit' për pjesën që mbulohet nga rezerva dhe për shtesat në aktiv. Për aktivet që i reduktohet vlera, pjesa e cila nuk mbulohet nga rezerva (ose kur nuk ka rezervë rivlerësimi) kontabilizohet në zërin "Fitim i mbartur" si një veprim axhustues.

Për kalkulimin e pjesës që do të regjistrohet në zërin "Rezervë nga rivlerësimi i aktivit", është shpërndarë efekti neto i diferencave të interesit efektiv të kapitalizuar dhe diferencat në amortizim sipas skedulit të amortizimit të interesit të kapitalizuar për çdo aktiv. Pjesa e kësaj diference që mbulohet nga rezerva e rivlerësimit do kontabilizohet në rezervë dhe pjesa e mbetur në fitim i mbartur.

Shoqeria kapitalizon kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar si pjesë e kostos së atij aktivi.

(h) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqeria ka një detyrim aktual ligjor apo të konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi i zbritjes në kohë njihet si kosto financiare.

(i) Grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Shoqeria do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur atyre. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Shoqerise, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të Shoqerise, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

(j) Kapitali aksionar dhe dividendët

Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionerin e Shoqerise njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqerise si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksioneri i Shoqerise.

(k) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqerise, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar bashkë në Shoqerian më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavaruara nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (njësia e gjenerimit të parasë ose 'NGJP').

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e NGJP-së së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NGJP-të shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (Shoqerian e njësive) në mënyrë përpjestimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm deri në masën që vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(l) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se ka ndodhur një ngjarje e cila ka sjelle humbje pas njohjes fillestare te aktivit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë mospagimin apo vonesat në pagesë nga debitorët, ristrukturimin e një shumë për t'iu paguar Shoqerise me terma të cilat Shoqeria nuk do t'i pranonte në një rast të kundërt si dhe treguesit që një debitor ose

emetues do të shpallë falimentimin.

Shoqeria konsideron evidencën e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme në nivel specifik dhe kolektiv. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të mëdha vlerësohen në mënyrë specifike për zhvlerësim. Të gjitha llogaritë e arkëtueshme individualisht të mëdha që nuk zhvlerësohen në mënyrë specifike, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë zhvlerësim që ka ndodhur, por që nuk është identifikuar ende. Llogaritë e arkëtueshme individualisht jo të mëdha vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar bashkë llogaritë e arkëtueshme me karakteristika të ngjashme rreziku.

Në përcaktimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqeria përdor tendencën historike të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar, korrigjuar sipas gjykimit të drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredidhënies janë të tilla që humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Një humbje nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme monetare të ardhshme skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provizioni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim humbje.

(m) Njohja e të ardhurave

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise transmetimin e energjisë, si dhe kryerjen e shërbimeve të lidhura.

Të ardhurat nga shërbimet e transmetimit njihen ne momentin kur transmetimi i energjisë ndodh, bazuar në sasinë e vërtetë të energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes, matur në pikën e shpërndarjes.

Të ardhurat përfaqësojnë vlerën fikse ose të përcaktueshme të cfare është marrë në këmbim ose është e arkëtueshme. Të ardhurat njihen me shumat e faturuara për konsumatorët dhe përjashtojnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, zbritjet dhe skontot.

(n) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi bazë neto.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi kreditë. Kostot e huave që nuk janë direkt të lidhura me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv.

(o) Tatimi mbi fitim dhe tatimi i shtyre.

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Shoqeria pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës në baza neto, ose aktivet dhe pasivet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Taksat e tjera që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Shoqeria njihen në të njëjtën kohë si detyrimi për të paguar dividendin e lidhur me të.

Një aktiv tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

(p) Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e qirave operative (pasi zbriten stimujt e pranuar nga qiradhënësi) njihen me metodën lineare në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë.

(q) Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Shoqeria është i detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Shoqeria është i angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur Shoqeria njeh kosto ristrukturimi. Nëse përfitimet nuk pritet të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontohen.

4.1 Riparaqitje

Ost sh.a ka bere riparaqitje per periudhat krahasuese si me 01 Janar 2014 dhe 31 Dhjetor 2014 per te paraqitur ne menyre retrospektive ndryshimin ne politiken kontabel per transferimin e shumes se rezerves se rivleresimit si dhe efektin e vleresimit me vleren e drejte te huave afatgjata ne momentin fillestar dhe mbjajtjen e tyre me kosto te amortizuar.

Ndikimet ne pasqyrat financiare te shoqerise paraqiten si me poshte:

(a) Riparaqitje e pozicionit financiar per periudhen 01 Janar 2014

(shumat jane te shprehura ne leke)	*OST sh.a. 31 Dhjetor 2013 (si ishte)*	*Efektet e riparaqitjes*	*OST sh.a. 01 Janar 2014 (e riparaqitur)*
AKTIVET			
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	38,821,487,846	578,884,529	39,400,372,375
Aktive afatgjata jomateriale	52,610,041		52,610,041
Aktive financiare afatgjata	117,844,960		117,844,960
	38,991,942,847	**578,884,529**	**39,570,827,376**
Aktivet Afatshkurtra			
Inventari	907,373,800		907,373,800
Llogari të arkëtueshme e të tjera	6,818,594,558		6,818,594,558
Aktive financiare afatshkurter	151,846,755		151,846,755
Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra	2,073,547,066		2,073,547,066
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	467,866,139		467,866,139
Tatim aktual i paguar teper	22,529,585		22,529,585
	10,441,757,902	**-**	**10,441,757,902**
Totali I aktiveve	**49,433,700,749**	**578,884,529**	**50,012,585,278**
Kapitali neto dhe detyrimet			
Kapitali			
Kapitali aksionar	9,694,008,000		9,694,008,000
Rezerva ligjore	364,791,062		364,791,062
Rezerva nga rivlerësimi per huate		1,441,063,232	1,441,063,232
Rezerva rivlersimi	10,831,146,267	(1,297,249,090)	9,533,897,177
Rezerva te tjera	471		471
Fitime te pashperndara	(1,684,364)	662,860,887	661,176,523
Fitime/humbje te vitit financiar	1,565,695,410		1,565,695,410
Totali I kapitalit neto	**22,453,956,846**	**806,675,029**	**23,260,631,875**
Detyrimet afatgjata			
Huate afatgjata	14,602,387,714	(1,514,861,908)	13,087,525,806
Llogari te pagueshme tregtare e te tjera afatgjata	404,502,255		404,502,255
Parapagimet dhe te ardhurat e shtyra			-
Grantet	659,906,172		659,906,172
Tatime te shtyra per PPE	1,550,348,099		1,550,348,099
